



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**V E N D I M**

Nr. 794, datë 17.12.2021

**P Ë R**

**MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE E POSTARE, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë e të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), për vitin 2022, në shumën 384 700 000 (treqind e tetëdhjetë e katër milionë e shtatëqind mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË**

**DELINA IBRAHIMAJ**

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**PASQYRA NR. 1**

**PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2022**

<b>Të ardhura</b>	<b>Në mijë lekë</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>Në mijë lekë</b>
Të ardhura nga pagesa për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	169 000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	117 400
Të ardhura nga pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave	128 300	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15 400
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26 300	Shpenzime për materiale	7 700
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	19 200	Shpenzime për shërbime	165 730
Të ardhura nga mbikqyrja e tregut të shërbimit postar	9 500	Shpenzime për investime	78 470
Të ardhura nga pagesa për <i>domain</i>	7 100		
Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	300		
Të ardhura nga Komisioni nga agjenti tatimor	25 000		
<b>Total i të ardhurave</b>	<b>384 700</b>	<b>Totali shpenzimeve</b>	<b>384 700</b>

NR.PROT. 6263/1  
DATË 20.12. 2021

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaçi', is written over a circular official stamp. The stamp is purple and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'MINISTRITË' at the bottom, with a central emblem.